

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI EKONOMIK**



LËNDA:

MIKROEKONOMIA

**Kapitulli 8: Oferta dhe përcaktimi i çmimeve në
konkurrencë të plotë**

Asistent: Msc. Neshat PODVORICA

E-mail: neshat.podvorica@uni-pr.edu

Dhjetor, 2019

Tiparet e konkurrencës

1. Egzistenca e **numrit të madh** të firmave;
 2. Firmat prodhojnë **produkte homogjene**;
 3. Blerësit dhe shitësit janë **të informuar**;
 4. **Hyrja dhe dalja** e lehtë e firmave nga dega.
 5. Si dhe janë **çmimpranuese**;
- Firmat mund të shesin aq sa prodhojnë.

Firma në periudhë afatshkurtër

- Si qëllim i firmës është maksimizimi i fitimit;
- **Fitimi = Të ardhurat – kostot**
- Cilët indikatorë duhet t'i dijmë për ta gjetur maksimizimin e firmës?
 - Kostot totale; Kostot margjinale; Kostot totale mesatare; Të ardhurat totale; Ardhurat Margjinale; Çmimin; Fitimi ose humbja.

Maksimizimi i fitimit TR TC

- Në mes të ardhurave dhe kostove.
- Paraqite grafikisht.


Q	TC	MC	ATC	P	TR	MR	π
0	5	-	-	5	0	-	-5
1	7	2	7	5	5	5	-2
2	8	1	4	5	10	5	2
3	10	2	3.3	5	15	5	5
4	13	3	3.2	5	20	5	7
5	17	4	3.4	5	25	5	8
6	22	5	3.6	5	30	5	8
7	28	6	4	5	35	5	7
8	35	7	4.37	5	40	5	5
9	43	8	4.7	5	45	5	2
10	52	9	5.2	5	50	5	-2



MR=MC
pra në
sasine e
6të
arrihet
kushti
MC=MR


Maksimizimi i fitimit në konkurrencë të plotë $MR=MC$

Firma është
cmimpranuese. Cmimi
varet nga tregu.



Q (milion)


(a) Industria



Q (Mijë)


(b) Firma

Humbja e firmës në konkurrencë të lirë



Q (milion)

(a) Industria



Q mijë)

(b) Firma

Deri kur prodhon firma?


- Deri në momentin kur humbja nga vazhdimi i prodhimit është më i vogël se kostoja fikse.
- Kjo paraqitet derisa çmimi është i barabartë me kostot variabile, që tregon që humbja është e barabart me kostot fikse.
- Pra, nëse çmimi më i vogël se AVC duhet të mbyllet

$$P < AVC$$

Sjellja e firmës dhe degës në periudha afatgjata

- Ekzistojnë tre periudha kohore:
 - **Ekilibri momental** – oferta është fikse;
 - **Ekilibri afatshkurtër** – mund të rritin njërin faktorë, zakonisht fuqia punëtore;
 - **Ekilibri afatgjatë** – të gjithë faktorët ndryshojnë, mund të ndryshoj edhe prodhimi.
- Në periudha afatgjata nuk ka kosto fikse;
- Si dhe mund të ketë hyrje të reja të firmave.

Ekilibri afatgjatë për një firmë konkurrese



Ekilibri afatgjatë për një firmë konkurruese

- Pra, firmat në periudha afatgjata realizojnë vetëm fitim normal, e jo fitim ekonomik.
- **Pse ndodhë kjo?**
- Sepse, nëse ka fitim ekonomik firma të reja do të futen në treg për të realizuar këtë fitim dhe fitimi kthehet deri në fitim normal.
- Dhe e kundërta nëse ka humbje një pjesë e firmave dalin nga tregu dhe mbesin firmat që kanë fitim normal.

Oferta e degës

- Degët dallojnë varësisht nga ndryshimet në kosto që ndodhin, e nga kjo ndarje kemi:
 - Oferta e degës me kosto konstante;
 - Oferta e degës me kosto rritëse; dhe
 - Oferta e degës me kosto zbritëse.

Oferta e degës me kosto konstante

- është ajo degë në të cilën me rastin e futjes së firmave të reja në degë dhe rritjes së prodhimit prapë kostoja për prodhimin e atyre produkteve mbetet e njëjtë.
- Pse dhe kur ndodhë kjo?
- Kryesisht në rastet kur këto degë kërkojnë sasi të vogël të lëndës së parë, apo ka lëndë të parë të mjaftueshme, P.sh prodhimi i lapsave nuk ndikon në rritjen e madhe të kërkesës për dru.

Oferta e degës me kosto rritëse

- Në rastet kur me futjen e firmave të reja në degë, bënë që të rritet kostoja e prodhimit të atyre produkteve paraqiten kostot rritëse.
- **Shembull**, nëse futen firma të reja për prodhimin e mobileve të ndryshme do të rritet kërkesa për dru, që njëherit do të ndikojë në ngritjen e cmimit të tij.
- Ndërsa për prodhimin e lapsave nuk ndodhte kjo sepse sasia e drurit që kërkohet është e vogël.

Oferta e degës me kosto zbritëse

- Në rast se me futjen e firmave të reja në treg bënë që cmimet e inputeve të ulen për shkak të ekonomizimit të shkallës apo faktorëve të tjerë paraqiten kostot zbritëse.
- **Shembull:** Një firmë e përpunimit të drurit me rastin e rritjes së kërkesës për dru mund të blejë makineri të re, që njëherit ndikon në shitjen e drurit me cmim më të ulët se më parë për shkak të kostove më të ulëta.

Efiqenca ekonomike (Efiqienca Pareto)

- është ajo situatë ku prodhimi i një malli të dhënë nuk mund të rritet pa ulur prodhimin e një malli tjetër, dhe kur konsumi i një konsumatori nuk mund të rritet pa zvogëluar konsumin e një konsumatori tjetër.

Ju faleminderit!